



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 28/2018 (JR)

Tiranë, më 15.03.2019

Nr. 28/2 regj.

SHPLLJE

E

NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces si dhe të gjithë personat e interesuar, se më **datë 16.04.2019, ditën e martë, ora 10:00**, do të gjykohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentash çështja me numër regjistri 28/2018(JR), datë 05.11.2018, për ankimin që subjekti i rivlerësimit Arben Nela ka bërë kundër vendimit nr. 44 datë 23.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese:	Rezarta Schuetz
Relatore:	Natasha Mula
Anëtare:	Albana Shtylla
Anëtare:	Ina Rama
Anëtar:	Sokol Çomo

Bazuar në nenin 49, pika 2 të ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim. Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të pakën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

KRYESUESI I TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE


REZARTA SCHUETZ

